



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO


www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Bazuar në nenin 108/A të LPP 05/L-068, Zyra e prokurimit, më datë 09.09.2019, merr këtë:

VENDIM



Hudhet poshtë kërkesa e për Ri-Shqyrtim e O.E. "COUOTA CLEAN GROUP - SHPK", nga KLINA, me të cilin ka paraqitur Kërkesë për Ri-Shqyrtim ne Vendimin e A.K. ,Për Shpërblim me Kontratë ne procedurën Ri-Vlerësimit 04.09.2019, ne Prokurimin nr. 634-19-5009-221 " : MIREMBAJTJA HIXHENIKE E OBJEKTEVE TE ADMINISTRATES, te bere nga O.E i pakënaqur ne platformen e- prokurimi me date 06. 09.2019 ne ora 15.40.

Arsyetim

Pas Vendimit per Ri-Vleresim te prokurimit nr. ne Prokurimin nr. 634-19-5009-221 " MIREMBAJTJA HIXHENIKE E OBJEKTEVE TE ADMINISTRATES, ku ne vlerësimin fillestar është bere gabim nga O.E , për shpërblim me kontrate TIKU nga Malisheva ka dorëzuar gabimisht Vërtetimin e ATK te vitit 2015,gjë qe pas te njëjtës dite është sjellë Vërtetimi i kërkuar i datës 15.08.2019 me nr, serik 1000621175 , qe është hetuar shume vone , dhe Është Kthyer lënda ne Ri -Vlerësim , ku gjate ekzaminimit Komisioni ka vlerësuar se Ky lëshim nuk mund te jete për te u Eliminuar si i papergjegjshem O.E " TIKI " nga Malisheva .

Kërkesa juaj e datës 06.09.2019 , potencon shkeljet neni 7 barazia ne trajtim ,Neni 59. Pika 1 Ekzaminimi Vlerësimi dhe Krahاسimi i tenderëve ,Dhe neni 60 pika 1. Kriteret për dhenje te kontratës

Konsiderojmë se as ju ne Kërkesën për Ri-Shqyrtim nuk keni gjetur shkeljet qe diskualifikohej O.E " Tiki " Nga Malisheva për mospërmbushje te kriterëve për shpërblim me kontrate , qe edhe vete keni aluduar se Vërtetimi i ATK ishte pa Afate.

Vërtetimi i sjellë me rastin e Ri -Vlerësimit i përmbush Kërkesat e pikës 65 te LPP dhe kërkesave te AK , për O.E fitues qe do te kërkohet Para vendimit për shpërblim me kontrate , gjë qe edhe është vepruar .

Këshilla juridike

Pala e pakënaqur bazuar në pjesa IX të LPP dhe nenit 109 ka të drejtë ankese në afatin ligjor në OSHP.

.Zyrtari pergjegjes i prokurimit
Abaz Foniqi

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për Kuvendin Komunal Klinë

Për Aktivitetin e Prokurimit: 634-19-5009-2-2-1

Sa i përket tenderit për **“MIREMBAJTJA HIXHENIKE E OBJEKTEVE ADMINISTRATIVE TE KOMUNES”**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

“COYOTE CLEAN GROUP” SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga “Lidhja e Prizerenit” p.n Klinë
(Adresa)

Klinë
(Vendi)

32000
(Kodi postar)

049-316 369
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Astrit Gjergjaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
coyotecleangroup@gmail.com
(Adresa elektronike)

06.09.2019
(Data e parashtrimit të kërkesës)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë është shpallur me datën 10.07.2019, ndërsa Afati i fundit për dorëzim të tenderit 22.07.2019, Njoftimi për dhenje të kontratës 09.08.2019 e prokurimi, Vendimi për Rivlersim 15.08.2019, Njoftimi për dhenje të kontratës pas rivlersimi 04.09.2019

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Procesi i hapjes së tenderit ka shkuar sipas procedurës së rregullt dhe nuk kemi patur vrejte lidhur me procesin e hapjes

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?

Po ☒

Jo ☐

Po jemi njoftuar përmes Letres Standarde për Tenderusein e pa sukseshëm

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1.NENI 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.
3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohej që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.
4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.
5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.
6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

2. NENI 59 pika 1 , Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tendervë Ligjit të Prokurimit Publik

1. Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do të nxjerrë legjislacionin detyrësor lidhur me këtë çështje.

3.NENI 60 pika 1 Kriteret për Dhënien e Kontratës

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm e kemi pranuar përmes platformës elektronike, me pas me datën 05.09.2019 kemi parashtrur Kërkesë për Qasje në Dokumentacion.

Gjatë qasjes në dokumentacion në kemi verifikuar edhe një herë se një numër të madh të shkeljeve që janë bërë në momentin e shpalljes fitues të Kompanisë NSH TIKI.

OE NTSH TIKI ka dorëzuar tenderin si operator i vetëm në platformën elektronike që verifikohet qartë edhe në lidhje të ofertës, ndërsa në dosjen e dorëzuar ka prezantuar Marrëveshjet e konzorciumit me kompaninë Kema-Compsny sh.p.k. si dhe dokumente të kompanisë në fjalë, duke shfrytëzuar dokumentacionin e tij për të përmbushur Kërkesat e FDT-së, duke marrë për bazë që OE NSH Tiki nuk e ka formuar konzorciumin në platformë elektronike konstatojmë se ky OE është i pa përgjegjshëm dhe që nuk i përmbush shumicën e kriterëve të FTD-së.

OE NTSH TIKI nuk ka ofruar Listë të maqinerisë apo marrëveshje për furnizimi por vetëm një përshkrim të përgjithshëm që do të kryhen, po ashtu OE i propozuar për kontakt nuk ka futur specifikimet teknike siq kërkohen në FDT por as Deklaratë mbi Specifikimet teknike që automatikisht duhet të shpallet i pa përgjegjshëm.

OE NTSH TIKI është shpallur fitues edhe me pare, ku me datën 07.08.2019 Autoriteti Kontraktues i ka dërguar Letër standarde kerkese për dokumentacion shtesë ku i ka kërkuar (1. Vertetimin nga ATK-qe nuk keni obligime të pa shlyera 2.Vertetimin nga gjykata për qeshtje ekonomike që nuk jeni në proces gjyqësor apo falimentimit të ndërmarrjes 3.Sigurimin e tenderit-Origjinal i bërë së fundit), ndërsa me datën 09.08.2019 OE Tiki ka ofruar Sigurimin e tenderit origjinal, Vertetimin nga gjykata ekonomike origjinal të datës 07.08.2019 si dhe Vertetimin e ATK-së të datës 29.06.2015 pa afat, ku me këtë verifikim të ATK-së të ofruar të viti 2015 AK është dashur të mos e shprehë me kontratë këtë OE herën e parë, dhe duke vepruar sipas LPP-së të ja konfiskoje sigurimin dhe të shpallë të pa përgjishëm, por AK e bërë shkelje për herë të dytë në momentin e shpalljes fitues të kompanisë NSH Tiki është dashur të shpallet i papërgjegjshëm dhe të eliminohet nga gara e jo të shpërblehet me kontratë dhe të ipej afat kohor për ta nxjerrur Vertetimin Tatimore.

Duke u bazuar ne gjetjet e larte shenunar kosntatojme se AK Klinë ne momentin e shpalljes Fitues te komapnisë NTSH Tiki ka bërë shkelje te LLP për te dyten here radhazi , nga qe ky operatore ekonomike nuk i ka permbusher Kerkesat e FTD-së ne momentin e dorzimit te tenderit , por as ne momentin e shpalljes fitues nuk ka mundur ti plotesoje Kerkesat qe jane kerkuar.

Kerkojme nga KK Klinë qe ta kthej lenden ne ri vlersim duke u bazuar ne faktet e ofruara te anuloi vendimin per shpallje fitues te kompanis NSH "Tiki" dhe te na shpalle neve fitues si operatore e pergjegjshem .

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Janë bërë dëme materiale dhe jomateriale për parapërgatitjen, përgatitjen dhe udhëheqjen e procesit për dorëzimin e ofertës (Shpenzime te letrës, stafit që kanë përgatitur ofertën, shpenzimet e sigurimit te tenderit, shpenzime te shërbimeve si noterizimet etj, shpenzimet e transportit si dhe dëmi moral lidhur me transparencën dhe jodiskriminimin).

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*